

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**PANELE EDI**

**Neni 1**

**THEMELIMI I SHOQERISE**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **PANELE EDI** është themeluar me Akt-Themelimi dt: 23.10.2023. Aktiviteti i kësaj shoqërie rregullohet me anë të këtij statuti. Shoqëria vpron në përputhje me ligjin nr Nr.9901, date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare”, dhe Ligjin Nr 9023 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, etj. në fuqi.

**Neni 2**

**EMERTIMI**

Emërtimi tregetar i Shoqërise është: **PANELE EDI**

**Neni 3**

**SELIA**

Vendi ku zhvillohet aktiviteti: do jëtë në territorin shqiptar. Selia e shoqërisë tregtare do të jetë në: **Lezhe, Ishull-Lezhe, ZK nr 1986, afer kryqezimit te Rriles, Autostrada Lezhe-Tirane, Km3.**



**Neni 4**

**KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë **PANELE EDI** është pa afat. Afati mund të caktohet ndryshe, apo te vihet në likujdim, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, ose të Ortakut të Vetem.

**Neni 5**

**PERGJEGJESITE**



Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortaku në emrin e tij personal ndaj përsoneve të tretë.

#### Neni 6

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti veprimtarisë ekonomike i shoqërisë me perjegjesi të kufizuar **PANELE EDI** është:  
Tregimi i paneleve diellore dhe materiale te tjera elektrike.

#### Neni 7

#### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqërise **PANELE EDI** në para në vlerë totale 1.000.000 (Nje milion) leke: me pjesmarrje të ortakeve si më poshtë:

1. **Z. Nikolin Ndreca**, 1 kuote = 500.000 leke e barabarte me 50% te kapitalit themeltar;
2. **Z. Pavlin Gjoni**, 1 kuote = 500.000 leke e barabarte me 50% te kapitalit themeltar.

#### Neni 8

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT

1-Në rastin e transferimit të kuotave të kapitalit, ortaku që kërkon të shesë kuotat e tij të kapitalit duhet të njoftojë me shkrim administratorin i cili njofton menjëherë Asamblene e Përgjithshme të Ortakeve për çmimin e shitjes së kuotave të ortakut që kerkon ti shesë.

2-Çmimi i kuotave ofertë për shitje duhet të vendoset në bazë te vlerës reale të Shoqërise në momentin e dhenies së të drejtës. Ortakët e tjerë mund ti blejnë në raport me kuotat ekzistuese duke ruajtur të njejtat raporte me kuotat që posedon secili.

3-Në qoftë se brenda 30 ditëve nga komunikimi i ofertës për shitje të kuotave të kapitalit të shoqërisë asnjëri nga ortakët e shoqërisë nuk shprehet për blerjen e tyre atëherë kuotat ofertë shitje mund ti transmetohen cdo përsori që kërkon ti blejë.

#### Neni 9

#### TRANSFERIMI TEK PJESTARË I FAMILJES

Pjesët e kapitalit janë ligjërisht të transferueshme mes bashkëshortëve si dhe mes paraardhësve dhe pasardhësve. Transferimi i pjesës së kapitalit mes bashkëshortesh në rast ndarje pasurie gjithashtu nuk kufizohet.

#### Neni 10

#### **TRANSFERIMI I KAPITALIT NE RRUGE TRASHEGIMIE OSE FALIMENTIMI**

1-Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzoterimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij, në rast se ky përson ishte zotërues ose trashëgimtar i vetem i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat vetemtë njojur nga shoqëria si gëzues i të drejtave mbi kuotën e tij. Pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetem apo së bashku me përsone të tjera.

2-Përsori që fiton të drejtën mbi një kuote si pasojë e vdekjes ose falimentimit të ortakut, pas paraqitjes së provave tëkërkura nga Administratori mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotës në emër të një përsori tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësiperm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës ai njofton shoqërinë në lidhje me ketë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një përsori tjetër të rregjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të përsorit tjetër.

3-Përsori që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejta që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve deri në momentin e rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Rregjistrimit.

#### Neni 11

#### **FORMA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT**

1-Kontrata për transferimin e pjesës së kapitalit duhet të jetë në formën e aktit notarial dhe në rast se pronari i ri nuk është ortak i shoqërisë, duhet të deklarojë shprehimisht në kontratë se është njojur me aktin e themelimit të shoqërisë dhe statutin e shoqërisë dhe se është dakort me to. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

2-Administratori, apo administratorët e shoqërisë mund të refuzojnë rregjistrimin e kalimit të kuotës së QKB në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se administratori apo administratorët nuk janë dakort me pësonin të cilit i kalon kuota.

3-Nëse administratori, apo administratorët refuzojnë të rregistrojnë kalimin e kuotës, ata njoftojnë për mospranimin pësonin të cilit i kalohet kuota brënda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për rregjistrimin e kalimit të kuotës.

#### Neni 12

#### **RRITJA E KAPITALIT THEMELTAR**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të rrisë pa kufij kapitalin e shoqërisë në çdo moment dhe një ose disa herë, me votim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, votues prezent apo përfaqesues sipas ligjit. Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës Asamblesa e per gjithshme e Ortakeve, vendos per perfitimet e realizuara. Asambleja mund te vendosë që me këto fitime të zmadhojnë kapitalin e rregjistruar, të rrisë rezervat statutore ose të shpërndaje divident. Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë pa mbuluar me parë humbjet e trasheguara ne pasqyrat financiare. Ne te gjitha rastet ndryshimet ne kapital pasqyrohen në pjesët e ortakëve në mënyrë proporcionale që janë deklaruar. Në përputhje me nenin 77 të ligjit nr .9901 para se të vendoset ndarja e dividentit administratori lëshon çertifikate të aftesisë paguese. Kjo çertifikate lëshohet vetëm nëse pas pagimint të dividentit, aktivet e shoqerise i mbulojne teresisht detyrimet e saj dhe se shoqëria ka aktive likuide te mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori njofton për rregjistrimin në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit



#### Neni 13

#### **KRIJIMI I REZERVAVE**

Pas miratimit të pasqyrave financiare, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve krijon rezerva statutore. Rezerva statutore duhet të jetë për cdo vit jo më pak se 10 % e fitimit vjetor. Kur këto rezerva të kapin Shumën 10 % të kapitalit themeltar mund të mos krijohen me rezerva.

#### Neni 14

#### **REDUKTIMI KAPITALIT THEMELTAR**



1-Kapitali themeltar mund të reduktohet me Vendimtë Asamblesë së Ortakëve, me votim të ortakëve prezente apo përfaqesuese që përfaqësojnë më shumë se  $\frac{3}{4}$  të kpitit të shoqërisë.

2-Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e përcaktuara me ligj.

3- Zvogëlimi i kapitalit të shoqërise përballohet nga secili ortak në mënyrë proporcionale sipas kuotave që zotërojnë. Asambleja e përgjitheshme e ortakëve mund të vendose zvogëlimin e kapitalit të shoqërise brenda limiteve të ligjit, qoftë edhe nëpermjet ortakut të vetem apo grupe ortakësh, aktivitetesh të shoqërisë apo aksioneve ose kuotave të shoqërive të tjera në të cilat shoqëria bën pjesë.

4-Vendimi për zvogëlimin e kapitalit njoftohet për regjistrim në QKR nëpermjet administratorit

#### Neni 15

#### PERFAQESIME I SHOQERISE

1-Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

2-Administratori

#### Neni 16

#### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Organ i vendimor i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **PANELE EDI** është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Vendimet e saj me shumicë pengojnë ortakët që mungojnë apo të papajtueshëm, përvèc rasteve të drejtës së tyre të kundërshtimit të ushtruar në raste, afate apo forma të parashikuara në ligj.

Gjatë kohës qe shoqëria do të ketë një ortak të vetëm të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra Asambleja e Përgjithshme apo ortaku i vetem rregistrohen në një rregjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Asambleja është organi mëi lartë vendimor i shoqërisë cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë lidhur me ceshtjet e aktivitetit të shoqërisë dhe për to vodos:

-Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.

- Ndryshimin e statutit
- Emërimin dhe largimin e administratorit
- Emërimin dhe largimin e likujduesve dhe ekspertit kontabel të autorizuar
- Përcaktimin e shpërblimeve për pësonat e emëruar likujdatore e ekspertë, përfaqesues neë gjykatë etj.
- Miratimin e bilancit vjetor, ndarjen e fitimit dhe mënyrën e ndarjes së humbjeve të shoqërisë.
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themelor.
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Ceshtje të tjera të parashikuara me ligj, të cilat ky statuti lë ne kompetence të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve

### Neni 17

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESE DHE VOTIMI**

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901 dt. 14.04.2008, ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interest e shoqërise. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të pakten një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit 9901 dt. 14.04.2008.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nesë, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të larte se 5 përqind të asetëve të shoqërisë, e rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit të saj, propozon te blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme paraqet një raport nga një ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kthehen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqeria zotërohet nga një ortak i vetëm.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolute këshilluese, duke miratuar apo bërë verejtje për veprimtarinë e administratorëve.

9. Vendimet në mbledhjen e asamblesë ose pas konsultimit me shkrim merren nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se tre të katrat e kapitalit themeltar, ky numër votash mjafton edhe për ndryshimin e statutit të shoqërisë.

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve rregistrohen me Proces-verbale dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e tyre.

### Neni 18

#### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

1. Ortaku ka të drejtë të informohet lidhur me administrimin e shoqërise, të njihet me bilancin vjetor dhe të kërkojë me shkrim sqarime të cilat i jep administratori mbledhjes së asamblesë.

2. Secili nga ortakët ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës që të heqë nga funksioni administratorin i cili ka shkelur ligjin.

3. Secili ortak që nuk është administrator, ka të drejtë ti paraqesë me shkrim dy herë ne vit administratorit pyetjet lidhur me problemet, ekzistanca e të cilave vë nedyshim vazhdimesinë e aktivitetit të shoqërisë. Lidhur me përgjigjen e administratorit vihet nëdjeni edhe eksperti kontabël i autorizuar.

4.Në rast se shoqëria nuk ka ekspert kontabël të autorizuar, atëherë emërtmi i një eksperti kontabël të autorizuar mund të kërcohët në rrugë gjyqësore nga një ose disa ortakë, pjesët e kapitalit të të cilevë perfaqësojnë të paktën 5% e kapitalit themeltar.

5.Një ose disa ortakë, pjesët e kapitalit të tëcileve së bashku përfaqësojne 5% e kapitalit themeltar, mund të kërkojnë në rrugë gjyqësore caktimin e një ose disa ekspertëve të ngarkuar për paraqitjene një raporti për njëapo disa veprimtari administrative. Raporti i ekspertit i dorëzohet ortakut/ortakëve që ka bërë kërkesën, administratorit, eventualisht ekspertëve kontabël të autorizuar , në qoftëse janë emëruar, raporti paraqitet në mbledhjen e ardhshme të asamblesë.

6.Ortaku nuk mund te marre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradeniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete. Ne rast te kundert veprimi eshte i pavlefshem, kjo vlen edhe per perfaquesuesit ligjore te tij, bashkeshortin si dhe per paraardhesit e pasardhesit e tij.

7.Ortaku, që eshtë person juridik, ështëi detyruar që menjëherë të njoftojë ortakët e tjerë lidhur me ndryshimet e statutit ose të perbërjes së organeve të tij.

8.Ortaku mund të përfaqesohet në asamblenë e përgjithshme në bazë tënës autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.

9.Administratoret e shoqërisë nuk mund të veprojne si perfaqësues të ortakëve në asamblene e përgjithshme.

#### Neni 19

#### ADMINISTRATORI

Shoqeria përfaqesohet nga administrator.

Ne emër të shoqërisë firmos administrator i cili bashkangjitet emërtimin e tregtar të shoqërise emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij.

#### Neni 20

#### EMERIMI I ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë **PANELE EDI** do të jetë **Z.Nikolin Ndreca**, me nr personal: **H30914078N**, i cili emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve me shumicën e zakonshme të votave të ortakëve.

Administratori mund të jetë ortak në shoqëri ose jo.

Administratori **Z.Nikolin Ndreca**, emërohet për një afat pesë vjeçar me të drejtë përsritje.

Asambleja e përgjithshme, mund ta shkarkojë atë në cdo kohë me shumicë të zakonshme.

### Neni 21

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ka të drejtë të veproje në emër të shoqërisë në marrëdhene me persona të tretë persa i përket të gjitha ceshtjeve me përjashtim të atyre qe ligji ose ky statut i lë në kompetence të Asamblese.
2. Administratori ka për detyrë në kuadrin e kompetencave të tij të sigurojë mbajtjen e rregullt të evidences dhe llogarisë sipas ligjit, të mbaje listen e të gjithë ortakëve dhe të informoje ortakët lidhur me ceshtjet që i takojnë shoqërisë.
3. Administratori ka për detyrë të ngrejë stafin drejtarët dhe të pajtoje punëmarrës në shoqeri në funksionet që ai i sheh të arsyeshme dhe nënshkruan kontrat e punës me punëmarrësit.

### Neni 22

#### DETYRAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori i shoqërise ka detyrë të krye funksionin e tij me kujdesin e duhur dhe të ruaje sekretin lidhur me informacionet dhe afatet konfidenciale, transmetimii të cilave tek persona te tretë mund të shkaktojë dëme për shoqërinë. Detyrimi për ruajtjen e sekretit vazhdon edhe mbas përfundimit të funksionit të administratorit.
2. Administratori përgjigjet për demin, të cilin e shkakton nga veprimet e kryera prej tij në dëm të shoqërisë.
3. Administratori nuk mund të marrë hua nga shoqëria, të miratoje née emër të shoqërisë paradheniet ose të bëhet garant për detyrimet ndaj personave të tretë. Në rast të kundert veprimi

është i pavlefshëm, kjo vlen edhe për përfaqesuesit e tij ligjore, bashkëshortin si dhe për paraardhësit apo pasardhësit e tij.

4. Administratori ka detyrë që të pakten një herë në vit t'i paraqesë asamblesë raportin mbi aktivitetin e shoqërisë dhe gjendjen financiare të saj.

5. Administratori përgatit dhe i paraqet asamblesë raportin lidhur me marrëveshjen mes atij ose një ortaku dhe shoqërisë. Ortaku që është pale e marrëveshjes nuk mund të votojë në mbledhjen e asamblesë. Administratori ose ortaku që nënshkruajnë një marreveshje pa miratimin e asamblesëi përgjigjen shoqërisë per demin e shkaktuar si pasoje e kësaj marreveshje.

#### Neni 23

#### **USHTRIMI VJETOR I SHOQERISE-PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE**

1. Viti ushtrimor i aktivitetit të shoqërisë mbyllt me datën 31 dhjetor. Në fund të vitit ushtrimor administratori procedon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave të ligjit, duke e shoqëruar me një relacion shtesë për aktivitetin e shoqërise.

2. Cdo ortak ka të drejtë të ketë nga administratori lajme mbi zhvillimin e punëve të shoqerisë dhe të konsultohet me librat e shoqërisë.

#### Neni 24

#### **NDARJA E FITIMIT**

Pas plotesimit të parashikimeve të nenit 77 të ligjit 9901 datë 18.04.2008, Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve, ose ortakut të vetëm të saj, mund të deklaroje shpërndarjen e dividenteve në përputhje me të drejtat përkatuese të ortakëve.

Fitimet neto që rezultojne nga bilanci vjetor, reduktuar me 5% (pesë perqind) të destinuar për rezerven ligjore, që arrin deri ne 10 % të kapitalit të shoqërisë, si edhe reduktimet eventuale të përcaktuara nga Asambleja, shpërndahen ndëmjet ortakëve në raport me kuotat e kapitalit që zotëron secili.

#### Neni 25

#### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHEVE**

Të gjitha mosmarreveshet që mund të lindin gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së shoqerisë nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e Akitit të Themelit dhe Statutit të shoqërisë si

dhe në përgjithësi të gjitha mosmarreveshjet e ortakëve, apo midis një ortaku dhe shoqërise në parim do të zgjidhen me mirëkuprimin dhe në bazë te Aktit-Themelimit dhe Statutit, në rast mungese të mirekutimit zgjidhja i besohet gjykates Shqiptare kompetente.

**Neni 26**

**SHKRIRJA E SHOQERISE**

Shoqëria shpërbëhet:

- Ditën e shënuar në vendimin e Asamblesësë Përgjithshme të Ortakëve për shpërbërjen e shoqërisë.
- Ditën e shënuar në rregjistrin tregtar të Qendres Kombetare të Rregjistrimit .
- Në raste të tjera të parashikuara me ligj.

**Neni 27**

**GJUHA**

Ky statut është redaktuar në Lezhe me date: 22.10.2023 në tre kopje origjinale në Gjuhën Shqipe.

**Neni 28**

**VULA**

Shoqëria do të ketë dhe vulën e saj.

**Neni 29**


**DISPOZITA E FUNDIT**

Përsa nuk është shprehur në këtë statut është kompetence e Asamblesë së ortakëve, ose Ortakut të Vetëm nëse shoqëria do të jetë me një ortak të vetëm, që të bëje plotësimin e dispozitave të këtij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave të cilat bëhen të pavlefshme dhe jo-efektive. Ndryshimet do të bëhen me vendimine e Asamblesë së Ortakëve, ne formën e një dokumenti notarial dhe do të depozitoohen në QKR.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**PANELE EDI**

**NIKOLIN NDRECA**



**PAVLIN GJONI**

